

ENTI RREGULLATOR I UJIT



SHOQËRIA RAJONALE UK LUSHNJE

ANALIZA E HUMBJEVE TË UJIT PËR VITIN 2022

Tiranë, 2023

Bilanci i Ujit
Analiza e Humbjeve te Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Lushnje

I. Të Përgjithshme mbi Hartimin e Bilancit të Ujit

ERRU harton çdo vit Raportin e Bilancit të Ujit për shoqëritë që operojnë në Sektorin Ujësjellës - Kanalizime. Ky raport merr një rëndësi të veçantë për një menaxhim racional të sektorit sepse trajton në mënyrë të veçantë treguesin e Ujit Pa të Ardhura, pra humbjet e ujit. Treguesi UPA lidhet ngushtësisht me cilësinë e shërbimeve që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve si edhe me qëndrueshmërinë financiare të tyre.

Organizimi i ri i shoqërive, në 15 shoqëri rajonale në sektorin UK, ka sjellë nevojën për një strukturim të ri të analizës mbi UPA dhe “Bilancin e Ujit” në tërësi. Analiza e humbjeve të ujit për çdo shoqëri rajonale kryhet duke analizuar fillimisht Bilancin e Ujit më vehte çdo njësi (ish shoqëri UK) që tashme është nën administrimin e shoqërisë rajonale të krijuar, dhe më pas analiza bëhet në mënyrë të integruar për shoqërinë rajonale në tërësi. Kjo qasje mundëson vënien në pah të problematikave individuale të çdo njësie të cilat duhet të kihen parasysh në të ardhmen për zgjidhjen, apo përmirësimin e tyre.

Kjo analizë i vjen në ndihmë çdo shoqëri rajonale duke i mundësuar asaj që nëpërmjet analizës së komponentëve përbërës të Bilancit të Ujit, për çdo njësi dhe në tërësinë e shoqërisë rajonale, të njihet në mënyrë analitike me nivelin e humbjeve(UPA), të nën komponentëve të saj, arsyet e veçanta të nivelit të lartë të humbjeve të ujit, nevojën dhe mënyrën e monitorimit të humbjeve, problematikat e faturimit me matje dhe aforfe, si dhe rekomandimet që ERRU jep për çdo shoqëri UK për të realizuar përmirësimet e nevojshme në punën e tyre.

“Bilanci i Ujit” si një instrument mjaft i rëndësishëm në përmirësimin e treguesit kryesor të performancës UPA duhet të hartohet me të dhëna sa më të sakta pasi hapat që do të ndërmerren për reduktimin e tij lidhen ngushtësisht edhe me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë. Si model i hartimit të Bilancit të Ujit do të përdoret ai i IWA (Shoqërisë Ndërkombëtare të Shoqërive të Ujësjellësve).

Duke patur parasysh gjendjen teknike të sistemeve të furnizimit me ujë si mungesën e matësve në burim, mos organizim të rrjeteve shpërndarëse bazuar në konceptin e Zonave me Matje të Pavarura (DMA-te), mangësitë në mjetet dhe metodat e monitorimit të konsumit, është vendosur që si metodologji e llogaritjes së nën komponentëve të Bilancit të Ujit të përdoret ajo nga “lart-poshtë” (top-down), ku fokusi kryesor në llogaritjen e humbjeve totale është përcaktimi i humbjeve të dukshme dhe më tej përcaktohen ato reale.

II. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Lushnje

Shoqëria rajonale UK Lushnje përbëhet nga ish shoqëritë UK ose Njësitë, përkatësisht UK Lushnje dhe UK Divjakë. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Lushnje jepen në **tabelën 1**.

Nga të dhënat e Tabelës 1, vërehet se dy ish shoqëritë UK të shoqërisë rajonale Lushnje nuk kanë probleme me faturimin me matje ish shoqëria UK Lushnje rezulton 131.6 l/ditë, banorë dhe ish shoqëria UK Divjakë 123.4 l/ditë, banorë duke patur parasysh që 100 l/ditë, banorë është konsumi mesatar ditor.

Probleme me faturimin aforfe rezultuan të dyja njësitë e shoqërisë Rajonale dhe njësia Lushnje (243,2 l/ditë, banorë) dhe Divjakë (161.5 l/ditë, banorë), të cilat janë më të larta referuar VKM nr.102, datë 16.03.1992 që duhet të jetë 150 litra/banor në ditë. Njësia Lushnje kryesisht, por dhe ajo e Divjakës duhet të analizojë arsyet e mbi faturimit aforfe (nëse përfshijnë në të dhe klientët jo aktive).

Tabela Nr. 1 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Shoqëria Rajonale UK Lushnje	Popullsia e Shërbyer	Konsumi Total (në m ³)	Konsumi i Matur (në m ³)	Konsumi Pamatur (në m ³)	Lidhjet me matës	Lidhjet pa matës	Konsumi i matur, aforfe, Total (l/ditë, banor)		
							Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
Lushnje	50,630	2,567,000	2,273,000	294,000	25,656	1,796	131.6	243.2	138.9
Divjakë	11,109	506,000	482,000	24,000	3,969	151	123.4	161.5	124.8
Totali	76,708	3,594,900	2,966,700	628,200	32,627	5,148	122.7	164.6	128.4

Nga ana tjetër referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 2, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre.

Tabela 2 Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Lushnje	Popullsia *e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futet në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Kapaciteti i Burimeve	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Lushnje	57,856	6,340,000	83.6	78,254	12,204,432	427	+343.7
Divjakë	12,861	1,078,890	99.3	23,386	883,008	103	+4.1
Totali	70,717	7,418,890	86.4	101,640	13,087,440	353	+266.4

* Popullsia në juridiksion u korrigjua duke u bazuar në të dhënat e INSTAT-it të publikuara në rang qarku në Janar të vitit 2023 ndërsa për popullsinë në shërbim si bazë përlogaritje shërbeu mbulimi me shërbim i raportuar nga vetë shoqëritë UK.

Nga tabela 2, shihet se shoqëria rajonale UK Lushnje ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit pasi ka një sasi të disponueshme 353 l/ditë, banorë. Por, duke e analizuar me njësi rezulton se burimet e njësisë Divjakë janë në limite përse i përket popullsisë në zonën e saj të shërbimit dhe që ka një kohëzgjatje të furnizimit me ujë 9 orë/ditë, kështu që kjo njësi në të ardhmen nëse do të këtë shtim të Kërkesës për Ujë duhet të shikojë opsionet e gjetjes së burimeve të tjera për plotësimin e kërkesës për ujë. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi.

II.1 UPA për Ish Shoqërinë UK Lushnje

Gjatë vitit 2022, ish shoqëria UK Lushnje ka raportuar sasinë e ujit të prodhuar 6,317,000 m³ ujë, i cili rezulton pothuajse 100% i matur, pasi vetëm 0.44% e tij vlerësohet.

Gjithashtu, rezulton nga raportimet tek të dhënat e monitorimit se njësia Lushnje 553,400 m³ ose 8.7% e sasisë së ujit të prodhuar blihet me shumicë.

Shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për rreth 73.9% të popullsisë në juridiksion, kjo njësi raporton 23,555 lidhje uji, prej të cilave janë të pajisur 99% me ujëmatës.

Uji Pa të Ardhura rezulton në nivelin 69.28%, që konsiderohet i papranueshëm për një shoqëri që ka patur investime serioze nga donatorët e huaj dhe nga buxheti i shtetit.

Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë është i organizuar pjesërisht me zona të pavarura me matje (DMA).

Në tabelën 3, paraqitet Bilanci i Ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Lushnje.

Tabela 3. Bilancit i Ujit për Ish Shoqërinë Lushnje- Viti 2022.

Emërtimi	Volumi i Ujit (ne m3)	Ndaj Ujit të Prodhuar (ne%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	6,368,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	1,887,000	29.63%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	69,000	1.08%
Faturimi Total	1,956,000	30.72%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	35,000	0.55%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	700,000	10.99%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	800,000	12.56%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	656,500	10.31%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	2,156,500	33.86%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	300,000	4.71%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	150,000	2.36%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	180,000	2.83%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	1,550,500	24.35%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	40,000	0.63%
Humbjet Reale (Teknike)	2,220,500	34.87%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	4,377,000	68.73%
UJI PA TË ARDHURA	4,412,000	69.28%

Komente :

- Treguesi i UPA në nivelin 69.28% të prodhimit vjetor, është i papranueshëm.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet i matur në nivelin pothuajse 100%.
- Niveli i humbjeve reale është 34.87% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, përkatësisht 24,35% nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës dhe 4,71% nga rrjedhjet në linjat e transmetimit.
- Numri i klientëve me ujëmatës është 23,324 klientë dhe përbëjnë 99% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 33.86% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili 23,55% vjen nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje dhe 10,31% si humbje nga pasaktësia në matje, nën faturim etj.

Rekomandime:

- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës të cilat janë në nivelin 24.35%, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit dhe të planifikohen fonde nga shoqëria për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktimin e ujit pa të ardhura.*

- Në lidhje me përqindjen e lartë 23.55% që zënë humbjet e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e shpërndarës dhe atë të transmetimit, kërkohet hartimi i një plani veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, krahas verifikimeve në terren (task-force) për lidhje dytësore sidomos në pronat private në zonat rurale, që mund të përdorin lidhje dytësore për ujitje.
- Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturimi etj. të cilat janë në nivelin 10.31% të ujit të prodhuar, njësia duhet të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin tek matësat apo tek nën faturimi duke kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësve etj.
- Shoqëria të shoh si prioritet ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, për të diagnostikuar ku janë problemet më të mëdha me humbjet, në bazë të të cilave do të hartohen planet e masave për zvogëlimin e tyre.

II.2 UPA për Ish Shoqërinë UK Divjakë

Gjatë vitit 2022, ish shoqëria UK Divjakë ka raportuar sasinë e ujit të prodhuar 1,239,000 m³, prej të cilit **64% është i matur** pjesa tjetër e vlerësuar.

Gjithashtu, rezulton nga raportimet tek të dhënat e monitorimit se njësia Lushnje 301,000 m³ ose 24% të sasisë së ujit të prodhuar e ble me shumicë.

Shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për 55% të popullsisë në juridiksion dhe raporton 6,607 lidhje uji, të cilat janë të pajisur 100 % me ujëmatës.

Uji Pa të Ardhura rezulton në nivelin 60.74%, i cili është nivel i papranueshëm.

Në Tabelën 4 paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Divjakë.

Tabela 4. Bilanci i Ujit për Ish Shoqërinë UK Divjakë – Viti 2022

Emërtimi	Njësia	Viti 2022	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	m ³	1,239,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	m ³	486,400	39.26%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	m ³	-	0.00%
Faturimi total	m³	486,400	39.26%
Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar	m³	6,000	0.48%
Humbjet e ujit nga lidhjet e të paligjshme në linjat e transmetimit	m ³	29,000	2.34%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës	m ³	364,000	29.38%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	m ³	38,000	3.07%
Humbjet e dukshme (administrative)	m³	431,000	34.79%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	m ³	65,000	5.25%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	m ³	16,500	1.33%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	m ³	12,500	1.01%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	m ³	220,000	17.76%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjellësit	m ³	1,600	0.13%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	m³	315,600	25.47%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	m³	746,600	60.26%
UJI PA TË ARDHURA	m³	752,600	60.74%

Komente :

- Treguesi i UPA në nivelin 60.74% të prodhimit vjetor, është i papranueshëm.
- Volumi i ujit të prodhuar raportohet i matur në nivelin pothuajse 64%.
- Volumi i ujit të blerë me shumicë është 301,000 ose 24% e volumit total.
- Niveli i humbjeve reale është 25.47% e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, ku kryesisht vijnë prej humbjeve ku zërin më të madh e zënë ato nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin (17.76%) dhe nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit (5.25%).
- Numri i klientëve me ujëmatës 6,607 lidhje uji dhe përbëjnë 100% të klientëve që përfitojnë këtë shërbim.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 34.79% vjen si rezultat i humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje (31,65%) është i papranueshëm.
- Pasaktësia e mundshme gjatë përlogaritjes të sasisë së ujit të prodhuar duke qenë se vetëm 64% e ujit matet, e bën relativisht të pabesueshëm vërtetësinë e vlerës absolute të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht nivel të pabesueshëm të treguesit UPA.

Rekomandime:

- *Duke patur parasysh që vetëm 64% e ujit që duhet për furnizimin me ujë të zonës së shërbimit, nevoja për investime në ujëmatësia në prodhim është e domosdoshme. Shoqëria duhet të marrë masa për gjetjen e këtyre fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për instalimin e tyre në mënyrë që të hartohet një bilanc uji sa më real.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme, Njësia duhet të ndër marrë plan veprimi për të përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve, që krahas verifikimeve në terren (task-force) të krahasohet edhe me bazën e klientëve të OSHEE-se, si edhe me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësorë.*
- *Njësia Divjakë të shoh si prioritet mundësinë e gjetjes së fondeve për ndarjen e rrjeteve të shpërndarjes në DMA, të cilat mundësojnë monitorimin më të mirë të humbjeve, diagnostifikimin dhe hartimin e planeve të masave për zvogëlimin e tyre.*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 17.76 %, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit dhe të planifikohen fonde nga shoqëria rajonale për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktimin e ujit pa të ardhura.*

III Përmbledhëse e UPA për Shoqërinë Rajonale UK Lushnje

Shoqëria Rajonale UK Lushnje, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Lushnje dhe Divjakë, ka në juridiksion 101,640 banorë.

Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet për **70,170 banorë** ose **69.6%** të popullsisë totale.

Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 30,162 lidhje, nga të cilat 29,931 ose 99,2 % lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor **7,607,000 m³** rezulton i matur në nivelin 94%.

Uji Pa të Ardhura është në nivelin **67.89%** të ujit që hyn në sistem.

Shoqëria faturon **2,442,400 m³** ujë ose **32.11%** të prodhimit.

Tabela 5, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2022, për Sh. Rajonale UK Lushnje.

Tabela 5. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Lushnje – Viti 2022

Emërtimi	Volumi i Ujit (ne m ³)	Ndaj Ujit të Prodhuar (ne%)
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	7,607,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,373,400	31.20%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	69,000	0.91%
Faturimi Total	2,442,400	32.11%
Konsumi i Autorizuar i Pa faturuar	41,000	0.54%
Humbjet e ujit nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit	729,000	9.58%
Humbjet e ujit nga lidhjeve e paligjshme në rrjetin shpërndarës	1,164,000	15.30%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	694,500	9.13%
Humbjet e Dukshme (Administrative)	2,587,500	34.01%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	365,000	4.80%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	166,500	2.19%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet dhe kapërderdhjet në depot e ujit	192,500	2.53%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes	1,770,500	23.27%
Humbjet e ujit nga riparimet në linjat e sistemit të Ujësjetësimit	41,600	0.55%
Humbjet Reale (Teknike)	2,536,100	33.34%
Humbjet Totale (Reale dhe të Dukshme)	5,123,600	67.35%
UJI PA TË ARDHURA	5,164,600	67.89%

Komente :

- Treguesi UPA në nivelin 67.89% të prodhimit vjetor është në një nivel të papranueshëm dhe shoqëria rajonale duhet të marri masa për përmirësimin e saj.
- Niveli i matjes në nivelin 94% për sasinë e “Ujit të Prodhuar” kërkon që shoqëria të thellohet në analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me nivelin e lartë të humbjeve.
- Konsumi total i faturuar është në nivelin 32.11%, prej të cilit vetëm 0.91% është konsum i faturuar i pamatur.
- Niveli i humbjeve reale është 33.34% ku 23,27% vijnë nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës dhe linjat e transmetimit 4.8%, konsiderohen shumë të larta. Shoqëria duhet të japë argumenta të mëtjshme për justifikimin e tyre dhe të analizojë situatën në terren për mundësinë e uljes së tyre.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 34%, me 24,88% që vijnë nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje dhe humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin 9.13%.

- Numri i klientëve me ujëmatës është 29,931 klientë dhe përbëjnë 99.2% të totalit të klientëve që e marrin këtë shërbim, për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.
- Në përgjithësi hasen mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit

Rekomandime:

- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të mundshme të lidhjeve të paligjshme në vlerën 24.88%, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi për të përcaktuar saktësisht bazën e klientëve bazuar edhe në bazën e klientëve të OSHEE-së, si dhe ngritjen e një Task Forcë për këtë qëllim.*
- *Të ngrihet një Task Forcë dhe një grup pune, i cili vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë për verifikime në vend për të thelluar analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika me ujin tek matësat duke kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësve etj.*
- *Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Për këtë duhet ti referohet problematikes në bilancin përkatës të çdo Njësie të veçantë. Humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës të cilat janë në nivelin 23.27%, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit, të bëhen përpjekje për gjendjen e fondeve nga qeveria qendrore ose nga fondet e veta për rehabilitimin ose zëvendësimin e tyre.*
- *Të trajtojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale.*
- *Të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.*
- *Të rrisë bashkëpunimin me ERRU-në për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe të dorëzojë atë në kohë pranë ERRU-së. Bilanci i ujit duhet të dorëzohet çdo 6 muaj për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërinë rajonale, duke filluar me vitin 2023, vërtetësia dhe saktësia e të dhënave të bilancit do të vlerësohet nga ERRU si penalitet ose bonus për shoqërinë raportuese.*